



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument Parlamentar

Tiranë, më 05.11.2018

RAPORT

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR 2017, PËR PROJEKTIN “PROMOVIMI I NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME PËRMES FONDIT TË GARANCISË SË KREDIVE RURALE””

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 05.11.2018, mori në shqyrtim projektligjin *“Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2017, për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale””*.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Edmond Leka.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm zëvendësministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Ilir Halilaj dhe përfaqësues të kësaj ministrie.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, që po paraqitet për ratifikim, do të ofrojë një kontribut shumë të rëndësishëm në promovimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit të garancisë, duke garantuar kreditë tregtare të institucioneve mikrofinanciare, dhe duke u dhënë mundësinë këtyre ndërmarrjeve për të qënë më konkurruese në treg.

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2017 për projektin “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale” konsiston në përdorimin e shumës së financimit me vlerë të përgjithshme prej 5 000 000 (pesë milionë) euro.

Hyrja në fuqi e kësaj marrëveshjeje paraqet interes në aspektin ekonomik dhe social, duke marrë në konsideratë nevojën për mbështetje financiare dhe shtysa të mëtejshme në fushën e promovimit të ndërmarrjeve të vogla e të mesme. Në Shqipëri, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme janë ofruesi kryesor i vendeve të punës dhe i rritjes ekonomike.

Marrëveshja e propozuar për ratifikim nga Këshilli i Ministrave paraqitet në vijim të tërheqjes nga dy marrëveshje të mëparshme financiare të lidhura më 6 korrik 2015, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale Gjermane për projektet “*Rifinancimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në zonat urbane dhe rurale*” faza e dytë si dhe projekti “*Eficienca energjetike nëpërmjet sektorit bankar*”, (përkatësisht me ligjet nr. 49/2018 dhe 50/2018 të datës 23.07.2018).

Tërheqja prej këtyre marrëveshjeve synonte të krijojne mundësinë e lidhjes së një marrëveshjeje të re më efçente duke qënë se Qeveria gjermane dhe ajo shqiptare kishin rënë dakord që promovimi dhe mbështetja e SME-ve në zonat urbane dhe rurale të realizohet nëpërmjet një projekti të ri, që mbështetet në fondin e garancisë së kredive rurale dhe që do të realizohet nëpërmjet hartimit të një marrëveshjeje të re ndërkombëtare.

Përdorimi i financimit, në vlerë të përgjithshme 5 000 000 (pesë milionë) euro, për zbatimin e projektit “Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet fondit të garancisë së kredive rurale” do të realizohet bazuar në kushtet dhe procedurat që do të përcaktohen në kontratat që do të lidhen ndërmjet KFW-së dhe të marrësve të shumës së financimit. Këto kontrata do t’iu nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë. Marrëveshja parashikon se premtimi i financimit, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen deri në përfundim të datës 31 dhjetor 2018.

Marrëveshja është miratuar në parim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 487, datë 31.07.2018 dhe pas nënshkrimit të palëve bazuar në procedurën e parashikuar nga ligji nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare”, i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë për ratifikim.

Kjo marrëveshje parashikohet të hyjë në fuqi ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë se janë përmbushur kushtet e përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm për hyrjen në fuqi të saj.

III. ÇËSHTJE TË DISKUTUARA NË KOMISION

1. Gjatë shqyrtimit të kësaj marrëveshje, nga anëtarët e komisioni u kërkuar shpjegime në lidhje mundësinë e përmbushjes së detyrimit të parashikuar në marrëveshje për lidhjen e kontratave përkatëse të financimit deri në datën 31 dhjetor 2018. Përfaqësuesit e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë, shpjeguan se përmbushja e këtij afati është e mundur dhe menjëherë pas ratifikimit dhe hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, do të procedohet me lidhjen e kontratës së financimit me KFW.

2. Një shqetësim i ngritur nga anëtarët e komisionit, gjatë shqyrtimit të kësaj marrëveshje, lidhet me mospërcaktimin e qartë të taksave dhe tatimeve, nga të cilat do të përjashtohet KFW-ja si dhe përgjegjësinë e mbulimit të tyre. Sipas vlerësimit të anëtarëve të komisioni, relacioni shoqërues i projekt-marrëveshjes duhet të ishte shterues dhe sqarues në këtë drejtim duke parashikuar në mënyrë të qartë, llojet e taksave/tatimeve nga të cilat përjashtohet KFW-ja gjatë zbatimit të marrëveshjes si dhe llojet e taksave/tatimeve që do të mbulohen nga Këshilli i Ministrave.

Në përgjigje të këtij shqetësimi, përfaqësuesit e ministrisë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, sqaruan se formulim i bërë në tekstin e marrëveshjes edhe pse bën një përcaktim më të diferencuar të taksave, nuk do të sjellë asnjë ndryshim në trajtimin fiskal të tyre nga ato të aplikuara deri tani. Duke marrë në konsideratë zbatimin e marrëveshjes se mëparshme, taksa e vetme për të cilën është aplikuar përjashtimi, ka qenë Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), e cila nuk mbulohet nga financuesi i huaj por përballohet si kosto lokale nga përfituesi vendas.

3. Në përfundit të shqyrtimit të kësaj marrëveshje anëtarët e komisionit, sollën në vëmendje të propozuesve, nevojën për paraqitjen e një informacioni më plotë në relacionin shoqërues të marrëveshjes lidhur me përfitimet nga marrëveshja, impaktimin social dhe ekonomik të saj, kjo referuar edhe angazhimeve të ndërmarra nga vendi ynë në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të paraqitura në Axiendën 2030 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORI

EDMOND LEKA

KRYETARI

ULSI MANJA